


NE, KRENARIA E SHTETIT



TË JETOSH NË DEMOKRACI

SHKURTE (13), ADRIANË (13), ENES (13), BRIKENA (12)



Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Se cilat janë disa nga elementet kryesore të kësaj udhëheqje, lexojeni artikullin për ta kuptuar

Që të kemi një shtet më të mirë, ne duhet të punojmë për të. Qytetarët janë ata të cilët e rregullojnë shtetin. Por, mund të jenë dhe ata të cilët e shkatërrojnë atë. Duke mos respektuar dhe duke mos përfillur ligjet, duke mos përkrahur njëri-tjetrin, duke menduar vetëm për vete, etj., ne vetëm sa e shkatërrojmë shtetin ku jetojmë. Kurse, që të zhvillohet shteti dhe të kemi një jetë sa më të mirë, duhet të mësojmë gjëra të reja, duhet të punojmë me përkushtim, duhet të jemi tolerant, duhet të bashkëpunojmë, etj.

Kosova është një vend demokratik dhe ne si popull i saj gëzojmë të drejta të barabarta pa dallim gjinie, race, moshe, feje, etj. Përveç të drejtave që i kemi, ne jetojmë të lirë në vendin tonë. Liria është gjëja më me vlerë në një shtet, dhe nëse nuk kemi liri atëherë nuk mund të jemi as të lumtur. Me pak fjalë, liria është një „dritare drejt harmonisë“.

Për ta kuptuar më mirë rëndësinë e lirisë dhe të drejtave në jetën tonë, në vazhdim do t'i tregojmë dy shembuj, ku njëri paraqet jetën me demokraci dhe tjetri jetën pa demokraci.

Ishte ende herët, sapo kishte aguar dielli, dhe cicërimat e zogjve dëgjoheshin si një freski shpirtërore. Fëmijët filluan të dilnin, disa prej tyre shkonin në shkollë, kurse disa të tjerë në kopshte. Në fytyrat e tyre shihej një gëzim dhe lumturi e madhe, sepse


të gjithë ata gëzonin të drejtën e shkollimit. Pra, të drejtat e këtyre fëmijëve mbroheshin me ligj, pasi që familjet e tyre jetonin në një vend demokratik. Ky është shembulli që na tregon se si është të jetohet në një vend ku ka të drejta të barabarta. Ishte acar, erërat fryenin nga çdo anë. Kishte ardhur koha që disa fëmijë të shkonin në shkollë. Por, disa të tjerë nuk shiheshin askund. Pra, jo të gjithë e gëzonin këtë të drejtë. Këtë e bënë vetëm fëmijët të cilët ishin nga familjet e pasura. Sa padrejtësi po bëhej ndaj këtyre fëmijëve! Ata nuk jetonin në një vend demokratik, dhe nuk kishte ligje që i mbronin të drejtat e tyre. Në fytyrat e tyre rrallë shihej buzëqeshja. Ky është shembulli tjetër se si do të ishte jeta po të mos i gëzonim të gjithë fëmijët të drejtat e barabarta. Pra, ne jemi të lirë dhe gëzojmë absolutisht të drejta të barabarta, sepse jetojmë në shtetin tonë demokratik. Për këtë duhet të jemi falenderues dhe të punojmë akoma edhe më shumë.



Duke bashkëpunuar, ndriçojmë vendin

PËR QYTETARINË AKTIVE

ELSË (12), DËBORË (12), ERINA (13)



Qytetaria aktive nuk është angazhim për dikë tjetër, por është thjesht një angazhim për vetë ne e për secilin nga ne. Këto angazhime mund të jenë për shtëpinë tonë, shkollën, komunitetin, por edhe më gjerë. Në artikullin tonë do t'i lexoni disa shembuj dhe mënyra se si ne jemi qytetarë aktiv

„Ndoshta nuk është shumë e drejtë të fillojmë të shkruajmë për aktivitetet tona si qytetare aktive pa treguar në fillim kuptimin e këtij termi,“ tha Elsa. Së pari ne do të tregojmë se kë e quajmë qytetar, e pastaj të kalojmë tek qytetaria aktive.

Qytetar është çdo person, i cili jeton brenda kufijve të një shteti të caktuar dhe ka leje qëndrimi në atë shtet. Çdo qytetar ka të drejtat e barabarta pa marrë parasysh etninë, fenë, gjininë apo kombësinë. Çdo qytetar ka përgjegjësi, si: respektimin e ligjeve, respektimin e njëri-tjetrit, pastrimin e ambientit, etj.

Qytetaria aktive përfshin angazhimin e qytetarëve në vendin ku jetojnë, si dhe jashtë tij. Për të qenë një qytetar aktiv, duhet t'i përmbushësh disa përgjegjësi, si: pjesëmarrja në shoqata të ndryshme, në votime, në tubime publike dhe në iniciativa të ndryshme për komunitetin. Po ashtu, edhe në shkolla duhet të ketë iniciativa të ndryshme, ku pastaj fëmijët mund të jenë pjesë e atyre iniciativave.

Disa nga aktivitetet që mund të bëhen në shkolla, e që u zhvilluan edhe në shkollën tonë janë: vendosja e thënieve të ndryshme nëpër pemë, ku të gjithë qytetarët që kalojnë mund t'i lexojnë dhe të vetëdijësohen nga to; shitja e ëmbëlsirave, ku me paratë e mbledhura do të mund të ndihmohen fëmijët e sëmurë; gara

volejboli dhe futboli, ku paratë e fituara nga ekipi do të dërgohen tek familjet që kanë nevojë. Mos të harrojmë që duhet të jemi qytetarë aktiv e jo spektatorë, qytetarë e jo subjekte. Nëse mendoni se jeni qytetarë aktiv, a i përmbushni edhe ju këto rregulla?



Qytetare aktive që nuk ndalemi asnjëherë

INSTITUCIONI PËRFAQËSUES

YLLGZONA (12), MEDIN (12), ERZA (12), HAXHERE (13)



Duke u bazuar në kërkesat tona si qytetarë të Kosovës, deputetët kanë obligim ndaj nesh që këto kërkesa t'i përmbushin gjatë mandatit të tyre 4 vjeçar

Ne jemi qytetarë të një shteti sovran dhe jemi shteti më i ri në Ballkan. Ne herë pas here kemi kërkesa që dëshirojmë të realizohen. Këto kërkesa ndryshojnë nga individ në individ. Vendi ku ne i paraqesim kërkesat tona është Kuvendi i Kosovës. Deputetët janë ata persona të cilët kërkesat tona i paraqesin në Kuvend. Ata duke biseduar përpiqen të gjejnë zgjidhje sa më të mira për qytetarët e Kosovës. Këto janë vetëm disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e deputetëve.

Edhe ne kemi rregulla të ndryshme në shkollë. Ora e mësimi fillon nga ora 8:00, por ne duhet të jemi 5 minuta më herët në shkollë. Këto rregulla vazhdojnë edhe në shtëpi, ku prindërit tanë kanë vënë rregulla si: të kemi një fjalor të pastër apo t'i ndihmojmë ata në punët e shtëpisë, pra t'i bëjmë punët e shtëpisë së

bashku. Kështu ne jemi demokratë edhe në shtëpi. Përveç këtyre rregullave edhe Kosova i ka disa rregulla shtetërore që quhen ligje. Këto rregulla vlejnë për të gjithë njësoj. Ligjet janë rregulla për të cilat marrin vendim deputetët në Kuvendin e Kosovës.

Tri funksionet kryesore të Kuvendit të Kosovës janë:

1. Funksioni përfaqësues, sepse deputetët e zgjedhur i përfaqësojnë qytetarët e Kosovës.
2. Funksioni legjislativ, ku deputetët i miratojnë ligjet e ndryshme. Para miratimit, ata edhe i kontrollojnë projektligjet nëse janë të nevojshme për qytetarët apo jo. Deputetët, nëse mendojnë që një ligj është i panevojshëm ose jo i duhuri, me anë të votave mund ta ndryshojnë apo ta shfuqizojnë atë. Për funksionin e tretë, do të lexoni në vijim.



Puna jonë në grupe



Ne synojmë që në të ardhmen të jemi përfaqësues të denjë

3. Funkzioni kontrollues, ku deputetët kontrollojnë punën e Qeverisë. Atë e bëjnë pasi e zgjedhin Kryeministrin dhe ministrat me anë të votave. Këta persona e përbëjnë institucionin e Qeverisë. Ata sigurohen që buxheti i shtetit po përdoret siç duhet dhe që qeveritarët po marrin vendimet e duhura për nevojat e qytetarëve.

Kuvendi ndryshe quhet „Shtëpia e Popullit“ dhe është organi më i lartë legjislativ i Republikës së Kosovës. Njihet si „Shtëpia e Popullit“, sepse të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve shqyrtohen aty dhe pastaj merren vendime të mëdha për to. Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë, të cilët janë zgjedhur nga votat e qytetarëve.


Si përfundim, ne kemi një kërkesë dhe mesazh për të gjithë. Ne mendojmë se duhet të respektohen dhe të

zbatohen të gjitha ligjet, sepse ato janë shumë të nevojshme. Ka shumë qytetarë të cilët gjatë udhëtimeve të tyre, ndalojnë në stacione për t'i furnizuar veturat e tyre me karburant. Ne i shohim tabelat ku shkruan: „Ndalohej pirja e duhanit“, por kemi vërejtur se këtë ligj e respektojnë vetëm klientët. Ndërsa, punëtorët të cilët punojnë aty, nuk e zbatojnë fare këtë rregullë dhe e konsumojnë duhanin brenda objektit. Jeta e qytetarëve, në këtë formë, rrezikohet nga kjo mospërfillje e ligjit. Ne kërkojmë nga këta punëtorë që të respektojnë këtë ligj, sepse ligjet janë rregulla që duhet të respektohen nga të gjithë.

Shpresojmë që ky ligj që e treguam dhe shumë ligje të tjera, do të zbatohen nga të gjithë. Me respektimin e ligjeve, jeta jonë është më e sigurt, më e qetë dhe më e lumtur.



Jemi të barabartë para ligjit. Kjo barazi sigurohet nga Kushtetuta e Kosovës dhe institucionet tona



Përgjegjësia që të kujdesemi për ambientin na takon të gjithëve



Vota ka fuqinë të sjell ndryshimin për shkak se ajo na takon neve, udhëheqësve të shtetit tonë!



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Hikmet“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Dobërçan, Gjilan